



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:038621

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05425073

Në ankesën e

AC-I-23-0192

Paditësi/Ankuesi

Sh R, i cili përfaqësohet nga avokatja S J, nga Prishtina.

Kundër

E paditura/Ankuesja

NSH, "Energomontimi"(në likuidim), të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe, Shkelzen Sylaj gjyqtar, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurës të paraqitur kundër Aktgjyimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2936 të datës 14 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 07 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.**
- 2. Ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar.**
- 3. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2936, i datës 14 mars 2023.**
- 4. Obligohet AKP-ja – Autoriteti i Likuidimit që në emër të shpenzimeve të përfaqësimit nga ana e avokatit ti paguaj paditësit shumën prej 208 euro, si dhe kompensimin e taksave**

gjqësore prej 40 euro, që do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 17 prill 2014, përmes postës paditësi e dërgoi në DHPGJS-ë një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN073-0119, të datës 12 mars 2014, me të cilën kërkesa e paditësit e datës 14 janar 2014 për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës në shumë prej 2,047,25 euro, refuzohet si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë paditësi ka pohuar se me datë 28 prill 2006, e ka pranuar njoftimin nga AKM-ja për ndërprerjen e marrëdhënies së punës si rezultat i privatizimit të NSH "Energomontimi" dhe në këtë njoftim ai ka pohuar se është theksuar se punëtorët do të njoftohen lidhur me kërkesat për pagat e pa paguara pas fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së. Tutje ai pohon se ka bërë kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me datë 14 janar 2014, e cila pa ndonjë bazë është refuzuar kinse është parashkruar kërkesa. Bashkë me ankesë paditësi ka dorëzuar autorizimin e avokatit, dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 14 prill 2022 , AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë mbrojtjen në ankesë në të cilën AKP-ja pohon se e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit, i cili ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se vendimi i ankimuar nuk bie ndesh me asnjë dispozitë ligjore të Ligjit të AKP-së, prandaj nuk ka bazë ligjore të shfuqizohet vendimi i ankimuar. Tutje AKP-ja pohon se NSH "Energomontimi" është privatizuar me datë 27 prill 2006, dhe të gjithë punëtorëve me këtë datë u është ndërprerë marrëdhënia e punës, prandaj punëtorët kërkesat për paga është dashur ti kërkojnë më së voni 3 vite nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. AKP-ja pohon se ajo nuk ka asnjë dëshmi se paditësi i ka kërkuar këto paga para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent në afat prej 3 vitesh, andaj kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Me datë 14 mars 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-IV-14-2936, ankesën e paditësit e aprovoj pjesërisht si të bazuar, e ndryshon vendimin e

ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, dhe e obligon AKP-në që paditësit në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, ti paguaj shumën prej 692.57euro, e cila do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Shkalla e parë e ka refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesës përtej shumës së aprovuar. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se mes palëve nuk është kontestues fakti se paditësi ishte një punëtor i NSH "Energomontimi" mirëpo kontestues paraqitet qështja e parashkrimit të kërkesës. E paditura pretendon se kërkesa për këto paga është e parashkruar, ndërsa paditësi e konteston këtë qëndrim të AKP-së, ndërsa bazën e kërkesës e mbështet në Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, Librezën e punës dhe në listat e pagave të pa paguara për muajt tetor 2005-mars 2006. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 28 prill 2006, kur NSH-ja është privatizuar, ndërsa në bazë të listave të pagave të paraqitura në Gjykatë nga paditësi shihet se në periudhën maj tetor 2005- mars 2006, NSH-ja paditësit në emër të pagave të papaguara i ka mbetur borxh 2,077.72 euro, dhe kjo shumë pjesëtohet për tre muaj, aq sa i takojnë paditësit në emër të kompensimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe atij i njihet shuma prej 692.57 euro, e cila do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuar me ligj në procedurën e likuidimit. Ndërsa pjesa tjetër e kërkesës në shumë përtej shumës së aprovuar nuk është mbështetur me provat e nevojshme materiale, andaj është refuzuar si e pabazuar. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se Gjykata u ka besuar këtyre provave andaj në bazë të tyre është aprovuar kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e datës 28 prill 2006, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kësi soji nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe ky njoftim nuk mund të shërbej si e vetmja bazë për t'ia njohur të drejtën për pagat e pa paguara, por duhet të shihet në lidhje me dëshmitë e tjera të dorëzuara nga ankuesi. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së në arsyetimin e Aktgjyqimit të ankimuar i është referuar edhe disa rasteve të mbyllura për të njëjtën NSH në jurisprudencën e Kolegjit të Apelit.

Me datë 30 mars 2023, AKP-ja përmes postës e dërgon një ankesë të afatshme kundër Aktgjyqimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-2936 të datës 14 mars 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet

ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit si dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes. Tutje AKP-ja pohon se Gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme, njëra që ndërlihet me afatin për parashtrimin e kërkesave i cili afat i përket procedurës së dorëzimit të dëshmisë së kërkesës dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat e të drejtës e që ka të bëjë me afatin e parashkrimit të kërkesës e që në këtë rast është 3 vite në bazë të nenit 608 të Ligjit të punës së Bashkuar. Tutje AKP-ja pohon se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës i dërguar tek paditësi ka pas për qëllim të informon atë se ai ka të drejtë të parashtroj kërkesë pranë AKP-së dhe se ky njoftim nuk i mbron të drejtat e tij dhe nuk siguron mjete ligjore që ai ka në dispozicion. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, pasi që ai nuk ka dorëzuar dëshmi të kërkuar këto paga brenda 3 viteve pas datës së privatizimit të NSH-së që ka ndodhë me datë 27 prill 2006.

Me datë 03 prill 2023, paditësi përmes postës e ka dërguar në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-VI-14-2936 të datës 14 mars 2023 për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe kërkon nga Kolegji Apelit të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet në tërësi padia si e bazuar. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se gjykata e Shkallës së I-rë ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale pasi që ai kishte kërkuar tek Autoriteti i Likuidimit kompensim për ndërprerje parakohshme të kontratës së punës e jo kompensim për pagesën e tri pagave të fundit të pa paguara. Paditësi ka pohuar se gjykata shumë e kërkuar prej 2,077.72 euro e ka përpjesëtuar në tri paga në shumë prej 692.57 euro. Në ankesë paditësi pohon se e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës është e garantuar me ligj andaj gjykata gabimisht ka vendosur kur e ka aprovuar vetëm shumë prej 692,57 euro. Në ankesë ai ka kërkuar të kompensohen edhe shpenzimet e përfaqësimit në shumë prej 312 euro si dhe kompensimi i taksave gjyqësore në shumë prej 40 euro.

Me datë 16 qershor 2023, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e

paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 02 qershor 2023, paditësi e ka pranuar ankesën e AKP-së, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në këtë ankesë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar bazuar.

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet .

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit e datës 14 janar 2014, e dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 2,047.25 euro nga NSH "Energomontimi" (në likuidim) është refuzuar si e pa vlefshme me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit vëren se edhe ankesa e paditësit e datës 17 prill 2014, i referohet kërkesës për kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme së kontratës së punës.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij në Shkallën e I-rë ka dorëzuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, ndërsa pas urdhrit të lëshuar me datë 20 tetor 2022 paditësi dorëzon autorizimin e avokatit, një kopje të listës përfundimtare për të drejtën legjitime për 20% dhe kopjen e listës së pagave nga muaji tetor 2005 deri mars 2006.

Paditësi në Shkallën e I-rë nuk e ka dorëzuar kopjen e Librezës së punës dhe Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Shkalla e I-rë duke u bazuar në provat e cekura pjesërisht e aprovon ankesën duke ia njohur paditësit të drejtën në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shume prej 692,57 euro ndërsa e refuzon pjesën tjetër të shumës prej 1,354.68 euro, me arsyetimin se kjo pjesë e kërkesës nuk është e mbështetur në prova.

Kolegji i Apelit në procedurën ankimore ka lëshuar një urdhër për paditësin me të cilën është kërkuar që ai të dërgon në gjykatë njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kopjen e Librezës së punës si dhe listën e pagave të papaguara për 3 muajt e fundit para privatizimit të NSH-së.

Paditësi është përgjigjur në urdhër dhe ka sjell njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe kopjen e librezës së punës si dhe listat e pagave.

Duke u bazuar në provat e cekura, Kolegji i Apelit vlerëson se Shkalla e I-rë me të drejtë paditësit ia ka njohur të drejtën për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës për tri paga bazuar në përvojën e tij të punës në shumë prej 692.57 euro, e cila duhet të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuar me ligj në procedurën e Likuidimit.

Njoftimi i AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës siç ka konstatuar shumë here Kolegji i Apelit në jurisprudencën e tij të deri tanishme, e ndërpre në rrjedhën e parashkrimit të kërkesës. Andaj është i pa bazuar pretendimi i AKP-së se kërkesa është parashkruar.

Kolegji Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij në Shkallën e I-rë ai kërkon vetëm borxhin kryesor 2,047.75 euro e jo dhe kamatën ligjor. Ai me ankesë në Shkallën e II-të e kërkon edhe kamatën ligjore, kjo në bazë të nenit 258 të LPK-së në këtë fazë të procedurës paraqet ndryshim të padisë, dhe më nuk është e mundur, andaj kërkesa për interes ligjor nuk është pranuar nga Kolegji Apelit.

Kolegji Apelit bazuar në nenin 62.2 të LDHP-së paditësit ia njeh të drejtën e kompensimit të shpenzimeve në emër të përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 208 euro, dhe kompensimin e taksave gjyqësore në të dy shkallët nga 20 euro ose në shumën prej 40 euro të cilat do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj.

Prandaj nga këto arsye është e aprovuar pjesërisht ankesa e paditësit ndërsa është refuzuar ankesa e AKP-së si e pa bazuar.

Prandaj nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesit tashmë e kanë paguar taksën gjyqësore me datën 1 qershor 2023 në shumë prej 100 euro dhe me datën 05 qershor 2023 në shumë prej 20 euro, për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 07 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
